



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1018/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hasan Softolli, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Podujevë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hasan Softolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Hasan Softolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal nga LDK-ja në Podujevë, në të cilën pretendon se ka mosperputhje të votave, sepse në bazë të dhënave që i ka marrë nga partia i ka mbi 320 vota ndërsa KQZ i ka publikuar vetëm 292 vota .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1018/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.